



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 586, datë 18.10.2023

PËR
PËRFUNDIMIN E AFATIT TË KOMANDIMIT SI NËPUNËS PËRGJEGJËS NË
NJËSINË E VLERËSIMIT PROFESIONAL DHE ETIK TË GJYQTARËVE
PRANË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, TË MAGJISTRATIT Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimet e tij nr. 218 datë 22.10.2019 “Për deklarimin e statusit të magjistratit për z. {...}” dhe nr. 585 datë 18.10.2023 “Mbi ngritjen në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të z. {...}”, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e afatit të komandimit në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të magjistratit z. {...} më datë 31.10.2023.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR